



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr. 05

Prishtinë, më 04.02.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S - II

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Jelena Bontiç, Bekim Haxhiu, Shpejtim Bulliqi, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyqi.
Mungoi Mufera Sinik.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësues të GIZ –it, përfaqësues të Agjencionit për Arsim dhe Aftësim Profesional në Kosovë, zyrtarët për media.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 28.01.2015;
3. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr.05-P-06/k, për propozimin e anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturor;
4. Takim i Komisionit me përfaqësues të GIZ;
5. Diskutim lidhur me Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë, i ftuar z.Ragip Gjoshi- Drejtor i Përgjithshëm i Agjencionit për AAPARr;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 28.01.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me 28.01.2015 u miratua pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr.05-P-06/k, për propozimin e anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturore

Nait Hasani kryetar i Komisionit, i njoftoi anëtarët tjerë që së bashku me zv kryetarin Salih Morina kanë realizuar takim me Ministrin e Kultures z. Kujtim Shala , për propozimin e anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturore, sipas Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr.05-P-06/k. Ministri Shala është pajtuar që në pajtim me Ligjin t'i procedojë Komisionit propozimet për anëtarë të Këshillit në afat të shkurtër, respektivisht gjatë javës së ardhshme.

Salih Morina tha se anëtarët e Këshillit për Trashëgimi Kulturore emërohen nga Kuvendi sipas Ligjit për Trashëgimi Kulturore. Çështja e propozimit të anëtarëve të Këshillit është kompetencë ekskluzive e ministrit, kur kemi parasysh vakumin ligjor që ekziston.

Kandidatët e propozuar nga Ministria bëhen sipas kriterëve të përgatitjes adekuate profesionale, si dhe përvojës së duhur në fushën e trashëgimisë kulturore. Lista me kandidatët e propozuar procedohet në Kuvend. Komisioni shqyrton propozimet dhe i rekomandon Kuvendit për emërim të shtatë anëtarëve.

Shukrije Bytyqi kërkoi sqarim lidhur me atë se në si anëtarë të Komisionit a kemi të drejtë të jemi anëtarë të këtij Këshilli, apo edhe të propozojmë ndonjë anëtarë, si dhe kërkoi që procedura e perzgjedhjes së kandidatëve nga Ministria të bëhet me konkurs publik.

Shpëtim Bulliqi shtroi dilemën rreth nocionit të trashëgimisë kulturore, me dyshim se si nocion mos është një nocion i ngushtë dhe në këtë aspekt a do duhej të përfshijë një nocion më të gjërë si për shembull gjeotrashëgimi që do të përfshinte edhe pjesën e trashëgimisë natyrore që në fakt janë të mbrojtura.

Ismail Kurteshi kërkoi që procedura e perzgjedhjes të bëhet me konkurs në mënyrë që të konkurojnë edhe kandidatët të interesuar nga komunat e ndryshme, si dhe kërkoi që Komisionit të dorëzohet lista e plotë e kandidatëve që kanë aplikuar, në mënyrë që Komisioni ti shqyrton të gjitha aplikacionet.

Salih Morina tha se çështja e propozimit të listës për anëtarë të Këshillit është kompetencë ekskluzive e ministrit dhe për shkak të zbrastisë së normave ligjore nuk mund të hapet konkurs për këtë çështje.

Bekim Haxhiu në diskutimin e tij, tha se është me rëndësi të procedohet lista me kandidatët në mënyrë që të funksionalizohet ky Këshill, si dhe përkrah idenë që procedura të bëhet me konkurs.

Komisioni, pas diskutimeve lidhur me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr.05-P-06/k, për propozimin e anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturore, vlerësoi se emërimi i anëtarëve të Këshillit duhet të bëhet në afatin sa më të shpejtë për shkak të rëndësisë që ka. Nga Ministria kërkohet që Kuvendit t'ia procedjë për shqyrtim dhe emërim listën me kandidatët për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

4. Takim i Komisionit me përfaqësues të GIZ

Komisioni zhvilloi një takim me znj. Dagmar Fuchs Schmittz, përfaqësuese e GIZ në Prishtinë. Ajo i njoftoi anëtarët e Komisionit me projektet e GIZ në fushën e arsimit, kualifikimet e mësimeve, përkrahjen e ofruar ndaj institucioneve të arsimit fillor në fushën e trajnimeve, testeve dhe analizave para dhe pas trajnimeve, dhe hulumtimet e ndryshme në cilësinë e procesit mësimor.

Nait Hasani tha se ndihma e GIZ në aspektin e praktikave dhe përvojave na ndihmon të kemi një arsim më cilësor, në këtë aspekt kërkoi përkrahjen dhe bashkëpunimin të mëtejshëm edhe në fushën e monitorimit të Ligjit për Inspektoratin e arsimit.

Jelena Bontiq në diskutimin e saj kërkoi bashkëpunim në fushën e monitorimit të ligjeve të arsimit si dhe kërkoi sqarim se a janë bërë hulumtimet në sistemin arsimor edhe në komunat serbe duke pasur parasysh se sistemi arsimor në komunat serbe funksionon i ndarë.

Bekim Haxhiu në diskutimin e tij, tha se përkrahë kërkesën për pajisje me diploma për ngritje të cilësisë, në këtë aspekt janë bërë edhe ndryshime të kurrikulave.

Ai shtoi edhe çështjen e peshës së çantave shkollore duke pasur parasysh që pesha e tyre është e madhe dhe në këtë aspekt 40% të fëmijëve të moshës deri 15 vjeqare kanë probleme shëndetësore si pasojë e peshës së çantave shkollore.

Në çështjen e dhunës në shkollë, tha se nevojitet një bashkëpunim dhe se kontributi i GIZ do të na ndihmojë në aspektin e monitorimit të ligjeve të kësaj fushe.

Teuta Haxhiu tha se kjo çështje është me interes për të gjithë mesimdhënësit të mësimin klasor duke pasur parasysh programin e ngarkuar nga klasa e pestë deri në klasë të nëntë. Në këtë aspekt ndihma e GIZ për monitorimin e mësimeve është shumë e rëndësishme dhe do duhet të bëhet. Ajo përmendi edhe numrin e vogël të inspektorëve të arsimit sidomos të fushës së matematikës, dhe kërkoi që të bëhet vlerësim dhe rangim të diplomave.

Shpejtim Bulliqi tha se përvojat dhe informatat nga GIZ na shërbejnë për angazhim të mëtejshëm për problematiken e arsimit.

Ismail Kurteshi tha se gjetjet në cilësinë e arsimit, niveli i performancës flasin për një gjendje jo të mirë në arsim, në këtë aspekt kërkon sqarim nga GIZ-i sa i përket inspektimit dhe testimit si të ngjitet cilësia dhe niveli i performancës.

Shukrije Bytyqi në diskutimin e saj tha se problemet me inspektor në fushat e arsimit janë evidente në këtë aspekt kërkon të mbahet edhe një takim tjetër me qëllim të bashkëpunimit të mëtejshëm.

Salih Morina tha se Komisioni ka në program ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Arsimit në këtë aspekt përvoja dhe praktika e GIZ-it do të shërbejnë Komisionit për një arsim më cilësor.

Nait Hasani tha se bashkëpunimi përmes miratimit, amendamentimit dhe monitorimit të ligjeve do të ndihmonte punën e Komisionit dhe në këtë aspekt pritet ndihma e GIZ-it.

5. Diskutim lidhur me Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë, i ftuar z.Ragip Gjoshi- drejtor i përgjithshëm i Agjencionit për AAPARr;

Ragip Gjoshi, drejtor i përgjithshëm i Agjencionit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë, z. i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me veprimtarinë e këtij Agjensioni, prioritetet dhe sfidat, si dhe aktivitetet që ka ndërmarrë ky Agjencion për avancimin e veprimtarisë së shkollave profesionale.

Ai foli edhe për kompletimin e bazës ligjore të Agjencionit, krijimin e kushteve sa më të mira për shkollat profesionale të cilat aktualisht përbëjnë 60 % të shkollave të mesme në Kosovë, dhe kjo sferë e arsimit kërkon një tretman të veçantë.

Nait Hasani tha se në aspektin ligjor do të bashkëpunojmë, praktikat që janë marrë duhet implementuar në mënyrë që shkollat profesionale të funksionojnë sipas standardeve të mira.

Salih Morina foli për rëndësinë e shkollave profesionale dhe interesimin e nxënësve për këto shkolla, në këtë aspekt kërkoi që shkollat profesionale të kenë drejtime të ndryshme varësisht prej specifikave të komunave në mënyrë që aplikohen.

Shukrije Bytyqi kërkoi nga Agjencioni të merr përsiper hulumtimin e tregut për shkollat profesionale, si dhe të kompletohet ligji për Agjencionin.

Ajo tha se duhet të parashihet numri i nxënësve nga Agjencioni si dhe të ngritet vetëdija e nxënësve për këto shkolla.

Bekim Haxhiu në diskutimin e tij tha se duhet praktikohen praktikat e mira të vendeve të ndryshme, të bëhet bashkëpunim me sektorin privat si dhe OEK –un, si dhe të krijohet mundësia që nxënësve të shkollave profesionale të vijojnë studimet në fushat e caktuara.

Teuta Haxhiu tha se duhet identifikuar problemet dhe pengesat, duhet harmonizuar planet dhe programet me praktikë në komunë të Gjakovës dhe Deqan, si dhe të hulumtohet tregu i punës.

Ismail Kurteshi tha se duhet inspektim i gjendjes në terren duke pasur parasysh se në shkollat profesionale ka pak nxënës, të hulumtohet tregu i punës si dhe të krijohen kushtet për mbajtjen e orëve praktike për nxënësit në këtë aspekt tha se mungojnë punëtoritë laboratorët etj.

6. Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës u diskutua lidhur me realizimin e vizitave të Komisionit gjatë javës së ardhshme në Drejtoritë Komonale të Arsimit, Rektoratet e Universiteteve Publike nëpër qendra të ndryshme të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani